

## **50 VENDE TË LIRA PËR PUNONJËS TË NIVELIT BAZË (GRADA INSPEKTOR) NË GARDËN E REPUBLIKËS**

### **Kandidatët për punësim në Gardën e Republikës do të ndjekin kursin e formimit në Kolegjin Profesional të Formimit Policor, në Akademinë e Sigurisë.**

#### **I. KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJNË KANDIDATËT :**

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të jetë i pajisur me vërtetimin e besueshmërisë;
- ç) të ketë përfunduar arsimin e mesëm;
- d) të jetë i moshës 19-30 vjeç;
- dh) të jetë i aftë nga ana shëndetësore për të kryer shërbim në struktura që, sipas ligjit, lejohet të mbajnë armë;
- e) të jetë me gjatësi trupore jo më pak se 175 cm për meshkujt dhe 170 cm për femrat;
- ë) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtjeje penale me dashje;
- f) të mos jetë në ndjekje penale;
- g) të mos jetë përjashtuar ose larguar nga puna për shkelje ligjore apo disiplinore;
- gj) të mos i jetë hequr e drejta e ushtrimit të funksioneve në administratën publike me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Aplikanti që nuk plotëson qoftë edhe 1 nga kriteret e mësipërme, nuk kualifikohet dhe nuk duhet të vazhdojë aplikimin.

#### **II. DOKUMENTAT QË DUHET TË PARAQESIN KANDIDATËT:**

Aplikantët duhet të paraqesin në fazën e parë të konkurrimit dokumentet e mëposhtëm:

1. Kërkesë
2. CV (Kurikulum vitae)
3. Kopje të kartës së identitetit
4. Dëftesën e shkollës së mesme ose listë notash, **të cikluar** në Drejtorinë Arsimore të Rrethit, **të fotokopjuar dhe të noterizuar**.
5. Vërtetim nga Gjykata
6. Vërtetim nga Prokuroria
7. Raport i aftësisë në punë (sipas shtojcës V, të VKM nr.596, datë 4.9.2019), nga mjeku i familjes.
8. Dëshmi për kualifikimet e kryera (nëqoftëse ka)
9. Deklaratë personale mbi pastërtinë e figurës (Plotësohet kur aplikanti paraqitet për testim)
10. Dy foto (9 X 12) me këmishë dhe kollare.

**Dokumentat do të dërgohen me postë në adresën: Garda e Republikës, Rruga e Elbasanit, Pallati i Brigadave, Tiranë, brenda datës 20.10.2022.**

#### **III. SHQYRTIMI I DOKUMENTACIONIT DHE PROCESI I ANKIMIMIT**

- Afati i shqyrtimit dhe verifikimit të dokumentacionit është 3 ditë pune nga mbyllja e afatit të aplikimeve.
- Aplikanti, që nuk plotëson kriteret dhe nuk ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të aplikimit, skualifikohet.

- Aplikanti ka të drejtën e ankimit brenda 2 ditëve nga data e njoftimit të përgjigjes. Komisioni i apelimit shqyrton dhe kthen përgjigje brenda 2 ditëve nga data e marrjes së ankesës me telefon ose adresë e-mail.

#### IV. TESTIMI I KANDIDATËVE

Kandidatët e kualifikuar në fazën e dorëzimit dhe kontrollit të dokumenteve, duhet të paraqiten **në orën 08<sup>00</sup> të datës 28.10.2022**, në adresën: Qendra e Aftësimit Profesional të Gardës së Republikës, Mullet, Tiranë.

**Kandidatët do t'i nënshtrohen testimit në tre faza:**

- Vlerësim i aftësive shëndetësore
- Intervista dhe testi psikologjik
- Testim i aftësive fizike

**Aplikanti skualifikohet në rastet e mëposhtme:**

- nuk kalon kontrollin shëndetësor
- nuk kalon testin psikologjik;
- nuk kalon testimin e aftësive fizike;
- nuk paraqitet në kohën e caktuar në një nga fazat e testimit;

Nr	ELEMENTËT TESTUES	PËR SASINË/ KOHEN		PIKËT
		Meshkuj	Femra	
1	Ulje – ngritje me forcën e krahëve (pompa) për kohën 2’.	60	30	25
		57	27	23
		55	25	20
		52	22	17
		50	20	15
		47	17	13
		nën.47	nën.17	10
2	Palosje – shpalosje me muskujt e barkut për kohën 2’.	60	30	25
		57	27	23
		55	25	20
		52	22	17
		50	20	15
		47	17	13
		nën.47	nën.17	10

3	Tërheqje në hekur	16	8	25
		15	7	23
		14	6	20
		13	5	18
		12	4	15
		11	3	13
		nën.11	nën.03	10
4	Vrapim rezistence 3000 m me uniformë sportive.	13'	16'	25
		13' 15''	17'	23
		13' 30''	17'30	20
		13' 50''	18'	17
		14'	18' 30''	15
		14' 30''	19'	13
		mbi 14' 30''	mbi 19'	10

#### **IV. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatët aplikues që të kualifikohen, duhet që në testimin fizik bazë të arrijnë rezultatin minimal 50 pikë. Rendiça e kandidatëve do të bëhet sipas rendit zbritës të pikëve.

#### **V. KOMUNIKIMI I REZULTATEVE TË KONKURIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, të gjithë kandidatët fitues në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike (e-mail personal) ose me telefon nga Garda e Republikës.